



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

**VENDIM**

**Nr. 114, datë 05.03.2020**

**PËR  
NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR FUNKSIONIMIN E SISTEMIT TË  
MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE PRANËGJYKATËS SË POSAÇME TË APELIT  
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të nenit 147 të Kushtetutës, dhe neneve 61, 89, 92, pika 2, dhe 94 të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 37 dhe 38 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në situatën e krijuar pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar,

**VENDOSI:**

1. Ngritjen e grupit të punës për marrjen e masave për të bërë funksional sistemin e menaxhimit të çështjeve pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me këtë përbërje:
  1. Z. Erjon Muharremaj, Kryetar – Anëtar i KLGJ;
  2. Znj. Elisa Spahiu, Anëtar - Specialist i Teknologjisë së Informacionit, në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
  3. Z. Klodian Kreçi, Anëtar - Specialist i Teknologjisë së Informacionit, në Këshillin e Lartë Gjyqësor;
2. Grupi i punës të mbajë në konsideratë në përmbushjen e detyrës së tij realizimin e proceseve të mëposhtme:
  - Kopje (backup) të databazës ekzistuese, në mënyrë që të garantojë kopjimin e të gjitha çështjeve, deri në momentin e përfundimit të veprimtarisë së Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda;
  - Implementimi i kodit në burim në pronësi të KLGJ-së për databazën ose nga kodi burim i databazës aktuale do të ngrihen në një databazë të re për Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
  - Mundësimin e funksionalitetit të sistemit ICMIS, duke kopjuar nga databaza e vjetër një sërë të dhënash të cilat mundësojnë përpunimin e çështjeve gjyqësore, si:
    - a) tipet e çështjeve;
    - b) regjistrin e çështjeve;
    - c) seksionet;
    - d) tipet e seancave;
    - e) rolet e përdoruesve;
    - f) përdoruesit, etj.

Këto informacione mbushin listat me të dhënat që përdoruesit zgjedhin gjatë përdorimit të programit ICMIS;

- Lidhja ndërmjet programit ICMIS dhe databazës të modifikohet në mënyrë që programi të lidhet me databazën e re dhe të shkëputet lidhja nga databaza e vjetër.
  - Administratori të logohet në sistem dhe të kryejë një testim të sistemit për të siguruar mbarëvajtjen e sistemit të ri.
3. Grupi i punës për të përmbushur objektivin e tij, të ftojë për të ofruar asistencën e duhur teknike ekspertë nga Misioni EURALIUS V.
  4. Afati për zbatimin e këtij vendimi është deri më datë 10 prill 2020.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

## **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**